

Njoftim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbi mbledhjen plenare datë 07.03.2024, ku ndër të tjera është emëruar në pozicionin e Prokurorit në Prokurorinë e Posaçme SPAK Z. Ols Dado.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RRETH NESH NUOFTIME SEANCA PLENARE LEGJISLACION PROGRAMI I TRANSPARENÇËS SEANCË DËGJIMORE

NJOFTIM PËR MEDIA MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PLENARE DATË 07.03.2024

BY KLP • 07/03/2024 • AKTIVITETE, PËR MEDIAT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, u mbledh sot në datën 07.03.2024 në seancë plenare, në prani të 10 anëtarëve, e në prezencë të përfaqësuesve të Programit OPDAT dhe EU4JUSTICE dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë kësaj seance u miratuan aktet si më poshtë:

- Procesverbalet e Seancave Plenare të datës 16.02.2024 dhe 27.02.2024;
- Vendimi për "Shqyrtimin e ankesës ndaj urdhrit Nr.7, datë 19.01.2024, të drejtuesit të Prokurorisë së Sh I të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër"; Ky urdhër u shfuqizua.
- Vendimi për "Shqyrtimin e ankesës ndaj urdhrit Nr.9, datë 30.01.2024, të drejtuesit të Prokurorisë së Sh I të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë"; Ky urdhër u shfuqizua.
- Vendimi për "Shfuqizim të vendimeve Nr.96, datë 09.05.2023, dhe Nr.125, datë 29.05.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë"; (Pas vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit).
- Vendimi për "Caktimin e përkohshëm të prokurorit Platin Aliçka në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë";
- Vendimi i për "Emërimin e zotit Ols Dado në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme (SPAK)";**
- Vendimi për "Caktim të zonjës Enkelelda Hoxha përkohësisht si drejtuese e Prokurorisë së Shkallës së Parë Kukës";
- Vendimi për "Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për prokurorin Urim Buci";
- Vendimi për "Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Urim Buci, kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër";
- Vendimi për "Verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Kreshnik Ajazi, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan".
- Vendimi për miratimin e veprimtarisë jasht funksioni (mësimdhënie) për prokuroren Suela Beluli.
- Vendimi për caktimin e relatorit në procedurën e ngritjes në detyrë për Drejtues në Prokurorinë Dibër. (shorti nërzindhi relatore zni. Mirela Rondani)

KËRKO

NJOFTIME

MBI THIRRJEN E KËSHILLIT NË SEANCË PLENARE PËR DATËN 18 MARS 2024

Seanca plenare Nr.199

NJOFTIM PËR MEDIA MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PLENARE DATË 07.03.2024

NEWSLETTER- FEBRUARY'24

BULETIN INFORMATIV – SHKURT'24

MBI THIRRJEN E KËSHILLIT NË SEANCË PLENARE PËR DATËN 07 MARS 2024

Informacioni i mësipërm është marrë në faqen zyrtare web të KLP në linkun:

<https://klp.al/2024/03/07/njoftim-per-media-mbi-zhvillimin-e-mbledhjes-plenare-date-07-03-2024/>